VENDIM
Nr. 136, datë 6.9.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PËRCAKTIMIN E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR TË LICENCUARIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të neneve 16; 17, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe nenit 26 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2017, pasi shqyrtoi propozimin e drejtorive teknike mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Referuar nenit 17, pika 4, ERE përcakton dhe miraton pagesën rregullatore që paguhet prej të licencuarve në përputhje me rregulloren përkatëse.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike".
2. Ngarkohet Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti